



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Komisioni për lejimin e dhënies së provimit të Jurisprudencës i caktuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit nr. 124, të datës 07/08/2019 lidhur me çështjen të cilën e keni adresuar sot me datë 26.12.2019 e që ka të bëjë me çështjem e kandidatit Ismajl (Idriz) Ismajli, jep këtë:

Shënim Zyrtar

Z. Ismajl (Idriz) Ismajli i lindur më 18.05.1968 në Gjilan tani me vendbanim në Rr.”Haki Taha” 36 në Prishtinë ka parashtruar kërkesën për komisionin për lejimin e dhënies së provimit të Jurisprudencës më datë 22.11.2019 me numër të protokollit 08-3096 për lejimin e dhënies së provimit të Jurisprudencës, në të cilin ka theksuar se i nënshtrohet provimit për herë të dytë.

Komisioni pas ri-shqyrtimit të lëndës sipas kërkesës tuaj, ka ardhur në përfundim se për shkak të një gabimi teknik, numrit të madh të kërkesave dhe në mungesë të një databaze ka rezultuar që të lartëcekurit i është lejuar nënshtimi i provimit të Jurisprudencës në afatin e Dhjetorit edhe për kundër faktit se i njëjti nuk i plotëson kushtet e parapara në nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-141 Për Provimin e Jurisprudencës më saktësisht kandidati ka rënë nga provimi me shkrim në afatin e Shtatorit të vitit 2019 dhe sipas dispozitave ligjore ai nuk mund të nënshtrohet provimit brenda afatit gjashtë (6) mujor nga data kur i është komunikuar nga Komisioni se “nuk e ka dhënë provimin”.

Me respekt,

Komisioni për lejimin e dhënies së provimit të Jurisprudencës